

VENDIM
Nr.413, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit).
Lista përbëhet nga 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, drejtori i Përgjithshëm i Rezervave të Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha